

## 3.1 HIDROIZOLUES NJË KOMPONENTËSH

### MONOFLEX



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes	54 cp/paletë	3-4 kg/m <sup>2</sup>	Gri



#### MONOFLEX

Material fleksibël hidrolizues një-komponentësh me aftësi të mira hidrolizuese dhe mbrojtëse.

#### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Material në formë pluhuri një-komponentësh me bazë çimento me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditiv special me veti hidrofobike. Materiali përziehet me ujë duke formuar një përzierje të lëngshme dhe homogjene. Është lehtësisht i aplikueshëm me spatul ose me furçë. Në sajë të përmbatjes të lartë të rezinave zotëron aftësi të mira ngjitëse.

#### KARAKTERISTIKAT

1. Nuk duhet të përdoret për hidrozolimim e sipërfaqeve plastike, drurit, kartonxhesit apo mure të lyer.
2. Mos shtoni në përzierje komponentë të tjerë si çimento, gëlqere etj
3. Mos e aplikoni në sipërfaqe të cilat mbajnë ujë të ndënjur.
4. Nuk duhet të përdorni produktin për të zgjidhur probleme të kondensimit të brendshëm, për këtë duhet të përdorni produktin përkatës.
5. Nëqoftëse produktit kërkojmë ti shtojmë elasticitetin mund ta përforcojmë me adetivin FLEXIT

#### FUSHA E APLIKIMIT

Shtrimin e membranave hidrozoluese përpara vendosjes së pllakave për brenda dhe jashtë. Përdoret për hidrozolimim e mureve nëntokësore të brendshme dhe të jashtme, depozitave të ujit, banjove, tarracave, ballkoneve dhe shatërvaneve. Mbrojtje fleksibël dhe rezistente ndaj ujit e lagështisë për sipërfaqet e betonit dhe suvatë. Nivelim hidrozolues dhe elastik i suvave të plasaritura.

#### PËRGATITJA E PËRZIERJES

Materiali përziehet me një sasi uji në varësi të formës së aplikimit. Nëqoftëse hidrolizuesi do të aplikohet me spatul, do të përziemi 6 - 7 L. Nëqoftëse produkti do të aplikohen me furçë përziemi 7 - 8 l ujë për çdo 25 Kg produkt. Përziemi përbërjen me një përzierës me xhiro të ngadalta derisa të formohet një përbërje homogjene. Përzierja lihet të pushojë për 10 minuta. Rekomandohet përzierja e përbërjes përpara përdorimit.

#### PËRGATITJA E SUPORTIT

Dysheme çimentoze në ballkone, tarraca, banjo etj. Sipërfaqja që do të izolohet duhet të ketë një pjerrësi të përshtatshme dhe nuk duhet të ketë gropa (gropat duhen të mbulojnë me FIBREN GP - 70). Nëqoftëse suporti ka mbetje telash apo hekurash të cilat dalin nga thellësia e betonit apo murit atëherë ato duhen prerë në thellësi 2 - 4 cm dhe më pas gropën e hapur e mbulojmë me mënyrën e përshtatshme më lart. Sipërfaqja që do të trajtohet duhet të jetë plotësisht e pastër, rezistuese dhe e qëndrueshme. Për izolimin e bodrumeve në ndërtesat e vjetra, duhet të hiqet çdo suvatim ekzistues deri në një lartësi prej 30 cm mbi nivelin e lagështisë dhe më pas të vazhdohet si më lart.

#### MËNYRA E APLIKIMIT TË PRODUKTIT

Hidrolizuesi aplikohet me spatul ose me furçë në varësi të trashësisë së sipërfaqes që do të hidrozolohet. Aplikimi me spatul bëhet në 2 - 3 duar por është e rëndësishme që kur të aplikohet dora e parë të lihet për 5 - 6 orë kjo në varësi të temperaturës së ambientit. Është e rëndësishme që dora (shtresa) e parë të jetë tharë plotësisht përpara aplikimit të shtresave të tjera të hidrozoluesit. Duhet të kushtohet kujdes aplikimit të shtresës së parë të hidrozoluesit duke bërë të mundur që të mbulohet me kujdes e gjithë sipërfaqja që do të hidrozolohet.



**TË DHËNA TEKNIKE**

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Dendësia e Përzierjes	1.30 gr/cm
Djegshmëria	I padjegshëm
Ruatja	12 muaj në ambalazh origjinal në vend të thatë
Raporti I Përzierjes	
Me spatul	
Me furçë 6 - 7 L ujë për 25 Kg MONOFLEX	
7 - 8 L ujë për 25 Kg MONOFLEX	
pH i Përzierjes	12
Kohëzgjatja përzierjes	45 min
Koha e aplikimit midis 2 duarve	Pas 4 orëve në 23°C
Trashësia max	

